

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar  
i Avancuar**

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

*Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme*

Data 21.09.2024

1. Johnson sh.a, është një shoqëri aksionare e cila operon në sektorin e shërbimeve në Kosovë. Johnson sh.a ka marrëdhënie biznesi me dy kompani të tjera Kosovare, Bird sh.a dhe Erving sh.a, të cilat janë gjithashtu shoqëri aksionare. Draft pasqyrat e pozitës financiar të këtyre tre kompanive janë dhënë më poshtë më 31 dhjetor 2023:

	Johnson sh.a €'milion	Bird sh.a €'milion	Erving sh.a €'milion
<b>Pasuritë</b>			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Pasuritë e Patundshme, Impiantet dhe Pajisjet	460.0	150.0	155.0
Investimet në filiale			
Bird sh.a	365.0		
Erving sh.a		160.0	
Investimet në Abdul-Jabbar sh.a	24.0		
Pasuritë e patrupëzuara	<u>99.0</u>	<u>15.0</u>	<u>17.5</u>
	948.0	325.0	172.5
Pasuritë qarkulluese	<u>447.5</u>	<u>240.0</u>	<u>125.0</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>1,395.5</b>	<b>565.0</b>	<b>297.5</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
Aksionet e zakonshme €1 secila	460.0	200.0	100.0
Komponentë të tjerë të ekuitetit	36.5	18.5	12.5
Fitimet e mbajtura	<u>447.5</u>	<u>221.0</u>	<u>69.5</u>
Total ekuiteti	944.0	439.5	182.0
Detyrimet aftagjata	247.5	61.5	46.5
Detyrimet aftashkurta	<u>204.0</u>	<u>64.0</u>	<u>69.0</u>
Total detyrimet	<u>451.5</u>	<u>125.5</u>	<u>115.5</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>1,395.5</b>	<b>565.0</b>	<b>297.5</b>

**Informata shtesë të rëndësishme:**

- i) Më 1 janar 2023, Johnson sh.a bleu 60% të aksioneve të zakonshme të Bird sh.a. Kostoja e investimit përbëhej prej €365 milion. Gjatë blerjes, vlera e drejtë e interesit jo kontrollues në Bird sh.a u vlerësua në €146 milion. Në datën e blerjes, vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të blera arriti në total €417.5 milion dhe fitimet e mbajtura të Bird sh.a u vlerësuan të ishin €159.5 milion ndërsa komponentët e tjerë të ekuitetit ishin €13.5 milion. Teprica në vlerën e drejtë rezulton nga një tokë e pa zhvlerësueshme.
- ii) Është politikë e grupit të masë interesin jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë në datën e blerjes.
- iii) Më 1 janar 2023, Bird sh.a bleu 70% të aksioneve të zakonshme të Erving sh.a për një shumë në para prej €160 milion. Vlera e drejtë e 30% të interesave jo-kontrolluese u vlerësua në €36 milion, dhe një pjesë prej 58% ishte €80.5 milion. Në datën e blerjes, pasuritë neto të identifikueshme të Erving sh.a kishin një vlerë të drejtë prej €181 milion, fitimet e mbajtura ishin €53 milion dhe komponentët e tjerë të ekuitetit ishin €10 milion. Teprica në vlerën e drejtë është për shkak të tokës së pa zhvlerësueshme.

- iv) Më 1 janar 2023, Johnson sh.a bleu një interes prej 14% në Abdul-Jabbar sh.a, për një shumë prej €9 milion. Investimi është kontabilizuar sipas SNRF 9 *Instrumentet Financiare* dhe është përcaktuar si me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Më 1 korrik 2023, Johnson sh.a bleu një interes shtesë 16% në Abdul-Jabbar sh.a për një shumë të parave prej €13.5 milion dhe arriti ndikim domëthënës. Vlera e investimit fillestar prej 14% më 1 korrik 2023 ishte €10.5 milion. Abdul-Jabbar sh.a realizoi fitime pas tatimit prej €10 milion dhe €15 milion për vitet deri më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2023 respektivisht. Më 31 dhjetor 2023, Johnson sh.a mori një dividend nga Abdul-Jabbar sh.a në vlerë prej €1 milion, i cili është kredituar në komponentë të tjerë të ekuitetit.
- v) Më 1 janar 2023 Johnson sh.a bleu patenta në vlerë prej €5 milion për t'i përdorur në një projekt për zhvillimin e produkteve të reja. Johnson sh.a ka përfunduar fazën e hulumtimit të projektit, duke shkaktuar një kosto shtesë prej €3.5 milion dhe tani ka përcaktuar se produkti mund të zhvillohet me fitim. U krijua një prototip efektiv dhe funksional me një kosto prej €2 milion dhe për ta vënë produktin në gjendje për shitje, u shpenzuan edhe €1.5 milionë të tjera. Në fund, kostot e marketingut prej €1 milion u shkaktuan. Të gjitha kostot e mësipërme përfshihen në pasuritë e patrupëzuara të Johnson sh.a.
- vi) Testet e dëmtimit u kryen si për Bird sh.a ashtu edhe për Erving sh.a më 31 dhjetor 2023. Shumat e rikuperueshme të të dyja njësive gjeneruese të parasë siç deklarohen në pasqyrat financiare individuale më 31 dhjetor 2023 ishin Bird sh.a, €712.5 milion, dhe Erving sh.a. €302 milion, respektivisht. Drejtorët e Johnson sh.a menduan se çdo dëmtim i pasurive ishte për shkak të performancës së dobët të pasurive të patrupëzuara dhe u mendua se pasuritë e tjera mbaheshin tashmë me shumën e rikuperueshme. Shumat e rikuperueshme janë përcaktuar pa i marrë parasysh detyrimet të cilat të gjitha lidhen me financimin e operacioneve.

**Kërkohet:**

**Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiar për grupin Johnson sh.a më 31 dhjetor 2023.**

**(30 pikë)**

**Johnson sh.a**  
**Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare të grupit më 31 dhjetor 2023**

€'milion

**Pasuritë**

*Pasuritë jo-qarkulluese*


Pasuritë e Patundshme, Impiantet dhe Pajisjet (460 + 150 + 155 +44.5 + 18)	827.5
Zëri i mirë (L13)	93.5
Pasuritë e patrupëzuara (99 + 15 + 17.5 - 4.5 -13.5)	113.5
Investimet në Abdul-Jabbar (L17)	25.25
Pasuritë qarkulluese (447.5 + 240 + 125)	<u>812.5</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>1,872.25</b>

**Ekuiteti dhe detyrimet**

Aksionet e zakonshme	460
Fitimet e mbajtura (L15)	489.41
Komponentë të tjerë të ekuitetit (L15)	<u>38.05</u>
	987.46
Interesi jo-kontrollues (L14)	<u>192.29</u>
	1,179.75
Detyrimet aftagjata (247.5 + 61.5 + 46.5)	355.5
Detyrimet aftashkurta (204 + 64 + 69)	<u>337.0</u>
Total detyrimet	<u>692.5</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>1,872.25</b>

**Llogaritjet**

**(L11) Struktura e grupit**



Interesi efektiv i grupit në Erving sh.a është 42% (60% x 70%).

Andaj IJK është 58% (100% - 42%).

Johnson sh.a (Interesi i grupit):	Bird sh.a	Erving sh.a
Direkt	60%	-
Indirekt	-	60% x 70% = 42%
Interesi jo-kontrollues:		
Direkt	40%	(100% - 70%) = 30%
Indirekt	<u>-</u>	40% x 70% = <u>28%</u>
	<b>100%</b>	<b>100%</b>

**(L12)****Neto pasuritë - Bird sh.a**

	<b>Data e blerjes</b>	<b>Data e raportimit</b>	<b>Ndryshimi</b>
	€ milion	€ milion	€ milion
Aksionet e zakonshme	200.0	200.0	-
Komponentë të tjerë të ekuitetit	13.5	18.5	5.0
Fitimet e mbajtura	159.5	221.0	61.5
Korigjimet e vlerës së drejtë - toka	<u>44.5</u>	<u>44.5</u>	-
	<b>417.5</b>	<b>484.0</b>	<b>66.5</b>

**Neto pasuritë - Erving sh.a**

	<b>Data e blerjes</b>	<b>Data e raportimit</b>	<b>Ndryshimi</b>
	€ milion	€ milion	€ milion
Aksionet e zakonshme	100.0	100.0	-
Komponentë të tjerë të ekuitetit	10.0	12.5	2.5
Fitimet e mbajtura	53.0	69.5	16.5
Korigjimet e vlerës së drejtë - toka	<u>18.0</u>	<u>18</u>	-
	<b>181.0</b>	<b>200.0</b>	<b>19.0</b>

**(L13) Zëri i mirë****Bird sh.a**

	<b>€ milion</b>
Vlera e drejtë e konsideratës	365
Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues	146
Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të blera (L12)	<u>(417.5)</u>
Zëri i mirë në blerje	93.5

**Erving sh.a**

	<b>€ milion</b>
Vlera e drejtë e konsideratës	160
Korigjimet e pronësisë indirekte (40% x €160)	(64)
VD e IJK-së në blerje (58% aksione)	80.5
Minus vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme (L12):	<u>(181)</u>
Zëri i mirë negativ në blerje	(4.5)
Zëri i mirë tek fitimi ose humbja	<u>4.5</u>
Zëri i mirë në datën e raportimit	-

**(L14) Interesi jo-kontrollues**

	<b>€ milion</b>
IJK në Bird sh.a në blerje	146
IJK % e fitimit pas blerjes (40% x (€484 - €417.5) (L12))	26.6
Korigjimet e pronësisë indirekte (40% x €160)	(64)
IJK në Erving sh.a në blerje	80.5
IJK % e fitimit pas blerjes (58% x (€200 - €181) (L12))	11.02
Dëmtimi (58% x €13.5 (L16))	<u>(7.83)</u>
	<b>192.29</b>



Kredi                      Fitimet e mbajtura                      €1.5 milion

Dividenti duhet të ishte kredituar në fitimin ose humbjen e Johnson sh.a dhe jo në TTGJ.

Debi                      KTE                      €1 milion

Kredi                      Fitimet e mbajtura                      €1 milion

Shuma e përfshirë në pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare do të ishte:

	<b>€'milion</b>
Kosto (€10.5 milion + €13.5 milion)	24
Pjesa e fitimeve pas blerjes (€15 milion x 6/12 x 30%)	2.25
Minus dividenda e pranuar	<u>(1.0)</u>
	<b>25.25</b>

Nuk ka asnjë dëmtim pasi vlera kontabël e investimit në pasqyrat financiare të veçanta nuk e kalon vlerën kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe as dividenti nuk tejkalon të ardhurat totale të përgjithshme të filialit në periudhën në të cilën është deklaruar dividenti.

Pjesa e grupit në lëvizjen e fitimeve të pashpërndara pas blerjes është €1.25 m (€2.25m - €1.0m). Kjo do të mbahet brenda fitimeve të grupit (L15).

#### **(L18) Zhvillimi**

Ekzistojnë kritere strikte në SNK 38 *Pasuritë e patrupëzuara* që rregullojnë zërat që mund të përfshihen në koston e një pasurie të patrupëzuar. Johnson sh.a duhet të njohë €5 milion si një pasuri e patrupëzuar plus koston e prototipit prej €2 milion dhe €1.5 milion për ta vënë atë në gjendje për shitje. Pjesa e mbetur e kostove duhet të shpenzohet duke përfshirë kostot e marketingut. Kjo është €4.5 milion, të cilat duhet të hiqen nga pasuritë e paprekshme dhe të shpenzohen.

Debi                      Fitimet e mbajtura                      €4.5 milion  
Kredi                      Pasuritë e patrupëzuara                      €4.5 milion

2. Më 31 dhjetor 2022, Olajuwon sh.a bleu €10 milionë obligacione me normë 5% në Durant sh.a me vlerë nominale. Obligacionet janë të ripagueshme me premi më 31 dhjetor 2025 dhe norma efektive e interesit është 8%. Modeli i biznesit i Olajuwon sh.a është shtë që të mbledh rryedhat e kontraktuara të parasë gjatë jetës së pasurisë. Më 31 dhjetor 2022, obligacionet u konsideruan si me rrezik të ulët dhe si rezultat, humbjet e pritura kreditore 12-mujore priten të jenë €10,000. Më 31 dhjetor 2023, Durant sh.a pagoi interesin e kuponit, megjithatë, në atë datë rreziqet që lidhen me obligacionet u konsideruan të ishin rritur ndjeshëm.

Vlera e aktuale e mungesës së parave të gatshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 është vlerësuar të jetë €462,963 dhe probabiliteti i mospërmbushjes është 3%. Më 31 dhjetor 2023, parashikohet gjithashtu që nuk do të pranohen pagesa të mëtejshme kupon gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2025 dhe vetëm një pjesë e vlerës nominale të obligacioneve do të paguhet. Vlera e tanishme e obligacioneve u vlerësua të jetë €6,858,710 me një probabilitet prej 5% për mospërmbushje në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

**Kërkohet:**

**Duke iu referuar SNRF-ve, llogaritni dhe diskutoni trajtimin e raportimit financiar të obligacioneve në pasqyrat financiare të Olajuwon sh.a më 31 dhjetor 2022 dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, duke përfshirë çdo humbje nga dëmtimi. (10 pikë)**



2. Modeli i biznesit i Olajuwon sh.a është mbledhja e rrjedhave të kontraktuara të parasë të obligacioneve gjatë jetës së pasurisë, obligacionet duhet të maten me koston e amortizuar. Të gjitha pasuritë financiare duke përfshirë pasuritë me kosto të amortizuar fillimisht duhet të njihen me vlerën e drejtë. Kjo do të ishte e barabartë me €10 milionë të paguara për blerjen e obligacioneve. SNRF 9 *Instrumentet Financiare* kërkon që entitetet të adoptojnë një qasje të vlerës së pritshme për marrjen në konsideratë të humbjeve nga dëmtimi në pasuritë financiare.

Me rastin e blerjes, obligacionet konsiderohen me rrezik të ulët dhe nuk janë të dëmtuara në aspektin kreditor. Obligacionet do të klasifikohen si një pasuri financiare e fazës së parë më 31 dhjetor 2022. Kjo nënkupton që Olajuwon sh.a duhet të krijojë një humbje të pritshme kreditore të barabartë me humbjet e pritshme kreditore 12 mujore. Është e rëndësishme të vlerësohet se humbja e pritshme kreditore 12-mujore nuk është humbja e pritshme kreditore gjatë gjithë jetës që do të pësojë një entitet dhe e cila parashikon se do të mos paguajë në 12 muajt e ardhshëm. Humbja e pritshme kreditore 12-mujore përkufizohet si një pjesë e humbjeve të pritshme kreditore gjatë gjithë jetës, të cilat përfaqësojnë humbjet e pritshme kreditore që rezultojnë nga një mospërmbushje brenda 12 muajve të ardhshëm. Në fakt, proporcioni i humbjeve të pritshme kreditore gjatë gjithë jetës, të cilat priten nëse një mospërmbushje ndodh brenda 12 muajve, ponderohen me probabilitetin që të ndodhë një mospërmbushje.

Prandaj, Olajuwon sh.a duhet të njohë një lejim të mospërmbushjes prej €10,000 më 31 dhjetor 2022. Kjo do të shpenzohet në fitim ose humbje dhe një provizion i veçantë i krijuar në vend që të kompensohet kundrejt obligacioneve €10,000,000. Megjithatë, lejimi është netuar nga obligacioni €10,000,000 në pasqyrën e pozitës financiare të Olajuwon sh.a më 31 dhjetor 2022. Vlera kontabël e obligacioneve në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2022 do të jetë €9.99 milion (€10 milion - €10 000). Duke qenë se obligacionet do të maten me kosto të amortizuar, norma efektive e interesit prej 8% do të përfshihet në fitim ose humbje dhe do t'i shtohet obligacioneve. Kjo është llogaritur në €10,000,000 fillestare dhe nuk ndikohet nga lejimi i humbjes prej €10,000. Interesi i kuponit prej €500,000 (€10,000,000 x 5%) zbritet nga vlera kontabël e obligacioneve. Kjo nënkupton që obligacionet do të kishin një vlerë kontabël prej €10,300,000 më 31 dhjetor 2023 përpara se të merret parasysh lejimi për dëmtim.

Tabela e koston së amortizuar 31 dhjetor 2023

<b>Saldo në fillim</b>	<b>Norma e interesit 8%</b>	<b>Norma e kuponit 5%</b>	<b>Saldo në fund</b>
€10,000,000	€800,000	€500,000	€10,300,000

Më 31 dhjetor 2023, ka pasur një rritje signifikante të rrezikut kreditor. Duke qenë se ende nuk ka ndodhur asnjë mospërmbushje aktuale, obligacionet duhet të klasifikohen si një pasuri financiare e fazës së dytë. Kjo nënkupton që Olajuwon sh.a duhet të bëjë një lejim për të njohur humbjet e pritshme kreditore gjatë gjithë jetës. Kjo përkufizohet si humbjet e pritshme kreditore (mungesa e parave) të cilat rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospërmbushjes gjatë jetës së pritshme të obligacioneve. Kërkohet një lejim i barabartë me vlerën aktuale të humbjes së pritshme në rrjedhat kontraktuale të parasë të ponderuara me probabilitetin e mospërmbushjes. Humbjet e pritshme të mospërmbushjes skontoen duke përdorur normën fillestare efektive të interesit prej 8%.

<b>Data</b>	<b>Llogaritja e humbjes së rrjedhës së parasë</b>	<b>Vlera aktuale e mospërbushjes</b>
31 dhjetor 2024	3% x €462,963	€13,889
31 dhjetor 2025	5% x €6,858,710	<u>€342,936</u>
		<b>€356,825</b>

Lejimi për humbjen e pritshme duhet të rritet në €356,825 me një shpenzim të regjistruar në fitim ose humbje prej €346,825 (€356,825 - €10,000). Lejimi për humbjen zbritet drejtpërdrejt nga obligacionet me të ardhura të ardhshme nga interesi të regjistruara në vlerën bruto. Vlera kontabël e obligacioneve më 31 dhjetor 2023 do të ishte €9,943,175 (€10,300,000-€356,825).

3.

a)

Bryant sh.a funksionon prej 5 vitesh si tregtar në industrinë e agrikultures me seli në Mitrovicë. Në vitin 2023, kompania vendosi të hapë dy pika, një në Zubin Potok dhe një tjetër në Zveçan. Informacioni i mëposhtëm është dhënë nga drejtuesit përkatës të degëve për vitin deri më 31 dhjetor 2023.

	Total	Mitrovicë	Zubin Potok	Zveçan
	€'000	€'000	€'000	€'000
Të hyrat nga klientët e jashtëm	2,250	1,700	300	250
Të hyrat brenda për brenda segmenteve	540	400	80	60
Kostot	1,880	1,300	380	200
Fitimi/(humbja)	890	800	(60)	150
Pasuritë	9,200	7,000	1,000	1,200
Detyrimet	5,350	4,000	650	700

Drejtorët e Bryant sh.a kanë përfshirë vetëm një shifër totale për të ardhurat, kostot, pasuritë dhe detyrimet në pasqyrat e Bryant sh.a për vitin deri më 31 dhjetor 2023 pa asnjë informacion tjetër shtesë në shënimet e pasqyrave..

**Kërkohet:**

**Shpjegoni natyrën e informative për segmentet që Bryant sh.a duhet të përfshijë në shënimet e pasqyrave financiare, duke identifikuar segmentet e raportueshme si pjesë e pasqyrave të saj financiare për vitin deri më 31 dhjetor 2023 në pajtim me SNRF 8 *Segmentet operative*. (10 pikë)**

**(b)** Barkley sh.a bleu një makinë paketimi sheqeri për përdorim biznesi për \$10,000 (USD) më 30 shtator 2023, por u bë funksionale më 1 tetor 2023. Barkley sh.a pagoi \$5,000 (USD) të kostos totale në të njëjtën datë dhe dhe pjesen e mbetur më 20 janar 2024.

Barkley sh.a zhvlerëson makineritë me një normë vjetore prej 25% mbi koston pa vlerë të mbetur.

Data	EUR për 1 USD
30 shtator 2023	10
31 dhjetor 2023	12
20 janar 2024	15

**Kërkohet:**

**Drejtorët e Barkley sh.a kanë nevojë për këshillën tuaj se si duhet ta trajtojnë transaksionin e mësipërm në pasqyrën e tyre financiare për vitin deri më 31 dhjetor 2023. (5 pikë)**

c) Ewing sh.a prezantoi një skemë të kontratave me mundësi zgjedhjeje për aksione (opsioneve të aksioneve) për punonjësit e saj më 1 janar 2022. Në të njëjtën datë, ajo dha 40,000 opsione aksionesh për secilin prej 120 punonjësve të saj me kusht që secili të qëndronte në kompani për pesë (5) vjet.

Më 1 janar 2022, Ewing sh.a priste që 10 punonjës të largoheshin nga kompania deri në fund të një periudhe 5-vjeçare. Në vitin 2022, 2 punonjës u larguan nga kompania dhe 9 punëtorë shtesë pritej të largoheshin në katër (4) vitet e mbetura. Më tej, 3 punonjës u larguan në 2023. Ewing sh.a pret që të largohen edhe 7 punonjës shtesë në tre (3) vitet e mbetura.

Vlera e drejtë e secilit opion jepet më poshtë:

<b>Data</b>	<b>Vlera e drejtë (€)</b>
1 janar 2022	50.00
31 dhjetor 2022	54.00
31 dhjetor 2023	60.00

**Kërkohet:**

**Drejtorët e Ewing sh.a kanë nevojë për këshillën tuaj se si duhet ta trajtojnë transaksionin e mësipërm në pasqyrën e tyre financiare për vitin deri më 31 dhjetor 2023. (5 pikë)**

### 3.

#### a)

Përshtatshmëria e përfshirjes vetëm të shifrave totale për të ardhurat, kostot, pasurit dhe detyrimet varet nga fakti nëse ka segmente të ndryshme operative që kanë përmbushur kriteret e parashikuara në SNRF 8 *Segmentet Operative* ose nuk ka asnjë. SNRF 8 përkufizon një segment operativ si një komponent [përbërës] i një entiteti:

- i cili merret me aktivitete biznesi nga të cilat mund të gjenerohen të hyra dhe të ndodhin shpenzime (përfshirë të hyrat dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me transaksionet me komponentë [përbërës] të tjerë të të njëjtit entitet)
- Rezultatet operative të të cilit rishikohen rregullisht nga vendim – marrësit kryesorë operativë [ekzekutivë] të entitetit të cilët marrin vendime për sa i takon burimeve që do të duhet të shpërndahen ndaj segmentit dhe vlerësojnë performancën e tij, dhe
- Për të cilin janë në dispozicion informacione financiare të veçanta

Tre degët e Bryant sh.a plotësojnë përkufizimin e një segmenti operativ. Ata gjenerojnë të ardhura dhe shkaktojnë kosto. Performanca e tyre vlerësohet rregullisht dhe informacioni financiar vihet lehtësisht në dispozicion nga menaxhmenti i degëve përkatëse. Thjesht plotësimi i përkufizimit të një segmenti operativ nuk mjafton për të justifikuar raportimin, nëpërmjet dhënies së shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare, informacion të veçantë për secilin segment raportues. Segmentet përkatëse operative duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në SNRF 8. Këto përfshijnë sa vijon:

1. Të hyrat e raportuara janë 10% apo më shumë se sa të hyrat e kombinuara të të gjithë segmenteve operative (të jashtme dhe brenda segmentit), ose
2. Shuma absolute e fitimit dhe humbjes së tij të raportuar është 10% ose më shumë së më e larta e, në shumën absolute, të gjithë segmenteve që nuk raportojnë humbje, dhe të gjithë segmenteve që raportojnë humbje, ose
3. Pasuritë e tij janë 10% ose më shumë së total pasuritë e të gjithë segmenteve operative.

Së paku 75% e totalit të të hyrave nga jashtë duhet të raportohen nga segmentet operative. Kur kjo nuk ndodh, segmente shtesë duhet të identifikohen (edhe nëse nuk e përmbushin kufirin prej 10%).

Zbatimi i kriterëve të mësipërme për Bryant sh.a jep sa vijon:

- 1) 10% e të ardhurave totale €279,000 (L11)
- 2) 10% e fitimit total €95,000 (L11)
- 3) 10% e humbjes totale €6,000 (L11)
- 4) 10% e totalit të pasurie €920,000 (L11)

Degët Mitrovicë dhe Zveçan i kanë plotësuar të gjitha kriteret. Të ardhurat, fitimet dhe asetet e tyre përkatëse janë më shumë se shifrat e mësipërme. Dega Zubin Potok në anën tjetër i ka plotësuar kriteret e të hyrave dhe pasurisë por humbja prej €60,000 është më e vogël se €95,000 që është më e madhe prej 10% të fitimit të përgjithshëm dhe 10% të humbjes totale. Më tej, 100% e të ardhurave totale të jashtme raportohet nga segmentet operative.

Bazuar në analizën e mësipërme, Bryant sh.a duhet të japë informacion shtesë për secilën degë në formën e dhënies së informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare në mënyrë që të jetë në përputhje me SNRF 8. Ajo duhet të japë informacionin e mëposhtëm:

- Fitimi ose humbja e segmentit operativ
- Pasuritë e segmentit
- Detyrimet e segmentit

#### L11 LLogaritja e kufijve

	<b>Total</b>	<b>10%</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Të hyrat e kombinuara	2,790	279
Fitimet e kombinuara	950	95
Humbjet e kombinuara	(60)	(6)
Total pasuritë	9,200	920

#### b)

Makina e paketimit do të përkthehet me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e blerjes prej €10/US\$. Kjo jep koston e makinës prej €100,000 (10,000 USD x €10/US\$). Kjo do t'i nënshtrohet rishikimit të zhvlerësimit dhe dëmtimit. Ngarkesa e zhvlerësimit prej €6,250 (€100,000 x 25% x 3/12) do të dergohet si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me më 31 dhjetor 2023. E njëjta shumë do t'i kreditohet makinës së paketimit për të arritur në vlerën e saj kontabël më 31 dhjetor 2023. Shuma prej €93,750 (€100,000 - €6,250) do të shfaqet si vlerë kontabël për makinën e paketimit nën pasuritë afatgjata në pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023.

Barkley sh.a do të duhet të përkthejë shumën e papaguar prej \$5,000 (USD) në datën e transaksionit duke përdorur kursin e këmbimit €10/US\$ dhe më pas të ripërkthejë duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit prej €12/US\$. Kjo jep shuma detyrimi prej €50,000 (\$5,000 USD x €10/US\$) dhe €60,000 (\$5,000 USD x €12/US\$) në 30 shtator 2023 dhe 31 dhjetor 2023. Prandaj, Barkley sh.a do të njohë një detyrim prej €60,000 si detyrim afatshkurtër në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023 dhe humbje nga këmbimi prej €10,000 (€60,000 - €50,000) në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

#### c)

SNRF 2 *Pagesa e bazuar në aksione* kërkon që transaksionet e shlyera me ekuitet që përfshijnë punonjës dhe të tjerë që ofrojnë shërbime të ngjashme të njihen në pasqyrat financiare të kompanisë bazuar në opsionet që priten të mbuloohen shumëzuar me vlerën e drejtë të opsionit në datën e akordimit 1 janar 2022 prej €50,00 gjatë gjithë periudhës së përfutimit të titullit. Vlera e drejtë e instrumenteve të ekuitetit të dhënë përdoret sepse është praktikisht e pamundur të vlerësohet me besueshmëri vlera e drejtë e shërbimeve të marra nga punonjësit. Kostoja më pas shpërndahet gjatë periudhës së përfutimit të titullit. Kjo është 5 vjet në rastin e Ewing sh.a.

Prandaj, Ewing sh.a do të njohë në ekuitet në pasqyrën e saj të pozitës financiare më 31 dhjetor 2023 një shumë prej €86,400,000 L11. Në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, ajo do të njohë kostot e opsionit në aksione të €42,800,000 (€86,400,000 - €43,600,000).

<b>L1</b>		<b>Ekuitet</b>	<b>Shpenzim</b>
<b>Viti</b>		<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
2018	[40,000 aksione x (120 - 2 - 9) x €50] x 1/5	43,600	43,600
2019	[40,000 aksione x (118 - 3 - 7) x €50] x 2/5	86,400	42,800

4.

a) Curry sh.a është një kompani që operon në shumë industri. Viti financiar i kompanisë përfundon më 31 dhjetor.

Më 1 korrik 2023, Phil Jackson, Drejtori Ekzekutiv i Nowitzki sh.a siguroi fonde prej €65 milionë për një projekt zgjerimi të Wade sh.a-së në Veriun e Kosovës, një kompani filial i Curry sh.a-së. Nowitzki sh.a mbante 52% të aksioneve me të drejtë vote në Curry sh.a më 31 dhjetor 2023.

Phil Jackson nuk mban poste drejtuese në bordet e Curry sh.a-së ose Wade sh.a-së. Wade sh.a emetoi aksione me vlerë €65 milionë për Phil Jackson më 20 shkurt 2024 për të paguar shumën që i detrohej atij.

**Kërkohet:**

**Identifikoni palët e lidhura për pasqyrat financiare të Curry sh.a nga faktet e mësipërme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 dhe kërkesat për shënime shpjeguese për palët e lidhura të identifikuar sipas SNK 24 Shpjegimet e palëve të lidhura. (5 pikë)**

b)

Më 1 tetor 2023, Garnett sh.a vendosi të shesë një nga divizionet e saj si entitet në vijimësi pas një ndryshimi të fundit në fokusin e saj gjeografik. Shitja e propozuar do të përfshinte blerjen nga blerësit të pasurive jomonetare (përfshirë zërin e mirë) të divizionit, me Garnett sh.a që arkëtoj çdo të arkëtueshme tregtare të mbetur në lidhje me divizionin dhe pagesen e çdo detyrim aktual. Më 1 tetor 2023, vlerat kontabël të pasurive përkatëse të divizionit ishin si më poshtë:

- Zëri i mirë i blerë, €600,000.

- Prona, impiantet dhe pajisjet dy (2) vite jetëgjatësi e mbetur e dobishme, €2 milion.

- Stoqet, €1 milion.

Nga 1 tetori 2023, Garnett sh.a filloi të tregtojë në mënyrë aktive divizionin dhe ka marrë një sërë pyetjesh serioze. Më 1 tetor 2023, drejtorët vlerësuan se do të merrnin €3.2 milionë nga shitja e divizionit. Që nga 1 tetori 2023, kushtet e tregut janë përmirësuar dhe më 31 janar 2024 Garnett sh.a mori dhe e pranoi një ofertë të fortë për të blerë divizionin për €3.3 milionë. Shitja pritet të përfundojë më 31 mars 2024. €3.3 milionë mund të supozohet se janë një vlerësim i arsyeshëm i vlerës së divizionit më 31 dhjetor 2023. Gjatë periudhës nga 1 tetor 2023 deri më 31 dhjetor 2023, stoqet e divizionit me vlerë €800,000 janë shitur për €1,200,000. Më 31 dhjetor 2023, kostoja totale stoqeve të divizionit ishte €900,000. Të gjithë këto stoqe kanë një vlerë të vlerësuar neto të realizueshme që është më e madhe se kostoja e tyre.

Garnett sh.a nuk e di se cili SNRF/SNK është i zbatueshëm për këtë çështje.

**Kërkohet:**

**Shpjegojini Garnett sh.a-së çështja e mësipërme duhet të trajtohen në pasqyrat financiare të Garnett sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. (5 pikë)**



(c) Në shtator 2024 drejtorët e Russell sh.a kanë përgatitur parashikime për pesë (5) vitet e ardhshme dhe janë të shqetësuar se kompania nuk ka asete të mjaftueshme likuide për të përmbushur planet e saj të zgjerimit në veri të Kosovës. Drejtorët propozojnë të mblidhen fondet e kërkuara në 1 tetor 2024 në një nga mënyrat e mëposhtme:

- i) Emetimi i 5 milionë aksioneve të zakonshme dhe
- ii) Emetimi i 10 milionë obligacioneve të konvertueshme. Interesi paguhet çdo vit me në fund të vitit. Mbjatësit e obligacioneve do të jenë në gjendje të shlyejnë obligacionet në formën e parave të gatshme ose një numër fiks të aksioneve të zakonshme të Russell sh.a.

Drejtorët nuk janë të sigurt për ndikimin e propozimeve në pasqyrat financiare.

**Kërkohet:**

**Diskutoni ndikimin e propozimeve të mësipërme në pasqyrat financiare të Russell sh.a. Përgjigja juaj duhet të marrë parasysh ndikimin e mundshëm në fitimin e thjeshtë dhe të tretur për aksion dhe në perceptimin e përdoruesve kryesorë për performancën dhe pozitën financiar të Russell sh.a. (5 pikë)**

(d) Një nga arsyet pse Stockton sh.a përgatit pasqyrat financiare duke përdorur Standardin e Entiteteve të Vogla dhe të Mesme është për shkak të vështirësive të përfshira sa herë që publikohet një standard i ri SNRF. Drejtorët besojnë se praktikrat dhe implikimet e pasqyrave financiare të zbatimit të SNRF-ve të reja janë tepër të vështira për një entitet të madhësisë së Stockton sh.a. Megjithatë, Stockton sh.a-së mund t'i duhet të kalojë në standardet e plota SNRF nëse vazhdon të rritet në madhësi.

**Kërkohet:**

**Diskutoni konsideratat kryesore praktike dhe implikimet e pasqyrave financiare që një entitet duhet të marrë parasysh kur zbaton një standard të ri SNRF. (5 pikë)**

a) Palët e lidhura të Curry sh.a janë:

- Phil Jackson (një personel kyç i menaxhmentit të kompanisë mëmë të Curry sh.a)
- Wade sh.a (një filial i Curry sh.a)
- Nowitzki sh.a (Kompania prind e Curry sh.a)

Marrëdhëniet ndërmjet një mëmë dhe filialeve të saj duhet të zbulohen pavarësisht nëse ka pasur transaksione ndërmjet tyre. Një entitet duhet të japë shënime shpjeguese për emrin e mëmës së saj dhe, nëse është ndryshe, palës përfundimtare kontrolluese.

Nëse një entitet ka pasur transaksione me palë të lidhura gjatë periudhave të mbuluara nga pasqyrat financiare, ajo duhet të japë shënime shpjeguese për natyrën e marrëdhënies me palën e lidhur, si dhe informacionin rreth këtyre transaksioneve dhe saldoeve të papaguara, duke përfshirë kushtet dhe angazhimet e nevojshme që përdoruesit të kuptojnë efekti e mundshëm të marrëdhënies në pasqyrat financiare.

Në këtë rast, deklaratimet e mësipërme të kërkuara duhet të bëhen veçmas për secilën nga kategoritë e mëposhtme.

- Prindi
- Filialet
- Personeli drejtues kryesor i entitetit ose mëmës së tij

b) Vendimi për të ofruar divizionin për shitje më 1 tetor 2023 me të gjithë treguesit e nënkuptuar kualifikues sipas SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera* do të thotë që nga ajo datë divizioni klasifikohet si i mbajtur për shitje. Divizioni është në dispozicion për shitje të menjëhershme, po tregtohet në mënyrë aktive me një çmim të arsyeshëm dhe shitja pritet të përfundojë brenda një viti. Pasoja e këtij klasifikimi është se pasuritë e divizionit do të maten me vlerën më të ulët të vlerës kontabël ekzistuese dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në këtë rast, kjo nënkupton matjen e asetëve të divizionit në €3.2 milion më 1 tetor 2023.

Zvogëlimi i vlerës kontabël të pasurive prej €400,000 (€2 milion + €1 milion + €600,000 - €3.2 milion) do të trajtohet si një humbje nga dëmtimi dhe do t'i shpërndahet zërit të mirë, duke lënë një vlerë kontabël për zërin e mirë prej €200,000 (€600.000 - €400.000). Pritshmëria e rritur e çmimit të shitjes prej €100,000 (€3.3 milion - €3.2 milion) do të trajtohet si një anulim i një humbjeje nga dëmtimi. Megjithatë, duke qenë se ky ndryshim lidhet me zërin e mirë, ai nuk mund të njihet. Pasuritë e divizionit duhet të paraqiten veçmas nga psuritë e tjera në pasqyrën e pozitës financiare. Klasat e tyre kryesore duhet të shpalosen veçmas, ose në pasqyrën e pozitës financiare ose në shënimet shpjeguese.

Prona, impiantet dhe pajisjet nuk duhet të zhvlerësohen pas datës 1 tetor 2023, kështu që vlera kontabël e tyre më 31 dhjetor 2023 do të jetë €2 milion. Stoqet e divizionit do të shfaqen me koston e tyre në fund të vitit prej €900,000. Divizioni do të konsiderohet si një operacion i ndërprerë në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Ai përfaqëson një linjë të veçantë biznesi dhe mbahet për shitje në fund të vitit. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të japë shënime shpjegues, si një shumë e vetme, fitimin ose humbjen pas tatimit të divizionit dhe humbjen nga dëmtimi që lind nga rimatja e divizionit sipas klasifikimit si të mbajtur për shitje. Analiza e mëtejshme e kësaj shume të vetme mund të paraqitet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, por mund të paraqitet në shënimet e pasqyrave financiare.

c)

### **Aksionet e zakonshme**

Aksionet e zakonshme nuk krijojnë një detyrim kontraktual për të dhënë para në dorë ose një pasuri tjetër financiare. Si të tilla, ato klasifikohen si ekuitet në pasqyrën e pozitës financiare. Nëse ekuiteti rritet, atëherë koeficienti i leverazhit do të përmirësohet, gjë që mund ta bëjë strukturën e financimit të Russell sh.a të duket më pak e rrezikshme për investitorët e saj. Dividentët e paguar për aksionet e ekuitetit nuk kanë ndikim në fitime sepse ato ngarkohen drejtpërdrejt në fitimet e pashpërndara. Dividentët janë, në thelb, shpërndarja e fitimeve të entitetit për aksionarët e saj. Emetimi i aksioneve të ekuitetit do të rrisë numrin e aksioneve të zakonshme në llogaritjen e fitimeve të thjeshta për aksion. Nëse entiteti nuk është në gjendje të rrisë fitimet e saj, atëherë fitimet e thjeshta për aksion mund të bien nga viti në vit. Investitorët mund ta perceptojnë këtë negativisht sepse është një tregues se kthimet e tyre të ardhshme të dividendit do të bien.

### **Obligacionet e konvertueshme**

Një obligacion që shlyhet në formën e mjeteve monetare ose në një numër fiks të aksioneve të ekuitetit të vet të entitetit ka karakteristika të borxhit dhe ekuitetit. Si i tillë, ai duhet të "ndahet" në një komponent detyrimi dhe një komponent të ekuitetit. Komponenti i detyrimit llogaritet duke marrë pagesat në para dhe duke i skontuar ato në vlerën aktuale duke përdorur normën e një obligacioni të ngjashëm jo të konvertueshëm. Diferenca midis të ardhurave monetare dhe përbërësit të detyrimit në datën e emetimit klasifikohet si ekuitet. Komponenti i detyrimit është zakonisht shumë më i madh se komponenti i ekuitetit. Si e tillë, emetimi i obligacioneve ka të ngjarë të bëjë që koeficienti i leverazhit të përqëndrohet, duke rritur perceptimin e investitorëve për rrezikun.

Kjo për shkak se detyrimet kërkojnë shlyerje të detyrueshme, ndërsa ekuiteti jo. Nëse obligacioni i konvertueshëm emetohet, atëherë një shpenzim vjetor i interesit do të ngarkohet në fitim ose humbje. Ky interes llogaritet duke aplikuar normën efektive të interesit për komponentin e detyrimit. Shpenzimet e interesit ngarkohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe kështu do të ulin fitimet dhe fitimet e thjeshta për aksion. Megjithatë, ndërkohë që janë në emetim, obligacionet e konvertueshme nuk kanë ndikim në numrin e aksioneve të përdorura në llogaritjen e fitimeve e thjeshta për aksion. Shumica e obligacioneve të konvertueshme janë instrumente tretëse. Kjo për shkak se entiteti ka një angazhim për të emetuar aksione të zakonshme në të ardhmen. Numri maksimal i aksioneve që Russell sh.a mund të emetojë për të shlyer obligacionet e konvertueshme duhet të përfshihet në llogaritjen e fitimeve të tretura për aksion. Për më tepër, shifra e fitimit të përdorur në llogaritje duhet të rritet me interesin e vitit aktual në obligacion sepse kjo nuk do të ngarkohet pas shlyerjes. Shpalosja e fitimeve të tretura për aksion paralajmëron investitorët aktualë dhe potencialë se fitimet për aksion do të bien kur të shlyhet obligacioni i konvertueshëm. Nëse investitorët janë të shqetësuar për rënien e mundshme dhe ndikimin që kjo mund të ketë në kthimet e tyre të investimeve, atëherë ata mund të vendosin të investojnë në kompani të tjera.

(d)

### **Konsideratat praktike**

Kur zbaton një standard të ri kontabël, një entitet duhet të përgatisë një vlerësim të ndikimit dhe projekt plan. Entiteti mund të ketë nevojë të shpenzojë para për trajnimin e stafit, ose për përditësimin ose zëvendësimin e sistemeve të tij. Proceset dhe kontrollet e reja mund të kenë nevojë të zhvillohen dhe dokumentohen. Standardet e reja të kontabilitetit me shumë gjasa do të përmbajnë kërkesa të reja për njohje, matje dhe dhënie të shënimeve shpjeguese. Nëse ndikimi i këtyre nuk komunikohet, atëherë vlerësimet e investitorëve se si menaxhmenti i ka përmbushur përgjegjësitë e tij mund të ndryshojnë dhe kjo mund të ndikojë në vendimet e tyre për investime. Si i tillë, menaxhmenti duhet të komunikojë ndikimin e një standardi të ri tek investitorët dhe palët e tjera të interesuara, veçanërisht nëse ai do të rezultojë në fitime më të ulëta ose në rritje të detyrimeve. Marrëveshjet bankare shpesh specifikojnë nivelet maksimale të borxhit ose koeficientët financiar bazuar në shifrat e raportuara në pasqyrat financiare. Kërkesat e reja të raportimit financiar mund të ndikojnë në këto koeficient, duke shkaktuar shkelje të mundshme të marrëveshjeve.

### Dividentët mund të afetktohen.

Shumë juridiksione kanë rregullore, të cilat kufizojnë shumën që mund të paguhet në dividendë. Ky kufizim zakonisht bazohet në fitimet kontabël. Ndikimi i adoptimit të një standardi të ri SNRF duhet t'u komunikohet analistëve. Disa qeveri përdorin informacionin e përgatitur sipas standardeve SNRF për qëllime të planifikimit statistikor dhe ekonomik. Avantazhi konkurrues mund të humbet nëse një standard i ri i raportimit financiar kërkon shënime shpjeguese të gjera. Skemat e bonusit mund të kenë nevojë të rivlerësohen sepse standardi i ri mund të ndikojë në llogaritjen e pagave të lidhura me performancën.

### **Implikimet e pasqyrave financiare**

Kur paraqitet një standard i ri kontabël, pasqyrat financiare do të duhet të pasqyrojnë kërkesat e reja për njohjen, matjen dhe dhënien e shënimeve shpjeguese, të cilat, nga ana tjetër, do të nënkuptojnë se entitetet do të duhet të marrin në konsideratë kërkesat e SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, vlerësimet në kontabilitet dhe gabimet*. SNK 8 përmban një kërkesë që ndryshimet në politikat kontabël të zbatohen plotësisht në mënyrë retrospektive, përveç nëse ka dispozita të veçanta kalimtare të përfshira në standardin e ri SNRF që po zbatohet. SNK 1 *Paraqitja e pasqyrave financiare* kërkon që një pasqyrë e tretë e pozitës financiare të paraqitet nëse entiteti zbaton në mënyrë retrospektive një politikë kontabël, riparaqet zërat ose riklasifikon zërat dhe këto rregullime kishin një efekt material në informacionin në pasqyrën e pozitës financiare në fillim të periudhës krahasuese. SNK 33 *Fitimet për aksion* kërkon që FPA e thjeshtë dhe e tretur të rregullohet për ndikimet e rregullimeve që rezultojnë nga ndryshimet në politikat kontabël të kontabilizuara në mënyrë retrospektive dhe SNK 8 kërkon dhënien e shënimeve shpjeguese për shumën e këtyre rregullimeve. Një ndryshim në një standard të kontabilitetit mund të ndryshojë vlerat kontabël të pasurive dhe detyrimeve, të cilat do të kenë pasoja tatimore të shtyra.

### **Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**

SNRF 1 *Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar* thotë se një entiteti duhet të përgatisë një pasqyrë hapëse të pozitës financiare në përputhje me Standardet SNRF në datën e tranzicionit. Data e tranzicionit është fillimi i periudhës më të hershme për

të cilën një entitet paraqet informacion të plotë krahasues sipas Standardeve SNRF në pasqyrat e saj të para financiare të prodhuara duke përdorur Standardet SNRF. Në datën e tranzicionit, entiteti duhet të:

- njoh të gjitha pasuritë dhe detyrimet e kërkuara nga Standardet SNRF
- çregjistroj pasuritë dhe detyrimet që nuk lejohen nga Standardet SNRF
- riklasifikojë pasuritë, detyrimet dhe ekuitetit në përputhje me Standardet SNRF
- matë pasuritë dhe detyrimet në përputhje me Standardet SNRF. Fitimet ose humbjet që lindin nga adoptimi i Standardeve SNRF në datën e tranzicionit duhet të njihen drejtpërdrejt në fitimet e mbajtura.

5. Payton sh.a dhe Kemp sh.a operojnë në të njëjtin sektor biznesi. Drejtorët e Payton sh.a dëshirojnë të kuptojnë pikat e forta dhe të dobëta në krahasim me Kemp sh.a nga pasqyrat më të fundit financiare të dy entiteteve siç janë paraqitur më poshtë:

**Pasqyrat e përmbledhura të fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**

	Payton sh.a	Kemp sh.a
	€'000	€'000
Të ardhurat	25,600	21,900
Fitimi neto	1,500	1,260
<i>Shifrat e fitimit neto u arritën pas marrjes parasysish ndër të tjera pikat e mëposhtme:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	3,110	2,850
Përfitimet e punonjësve	7,200	6,050
Kosto financiare	1,050	880
Provizionet për tatimin aktual – 2023	1,004	925
Tatimi i shtyrë (zvogëlim në provizione) – 2023	116	55
Tatimi aktual (nën provizionim) (2022)	-	32

**Pasqyrat e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023**

	Payton sh.a	Kemp sh.a
	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Pasuritë e patrupëzuara	18,300	16,770
Të arkëtueshmet	<u>2,500</u>	<u>3,020</u>
	20,800	19,790
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	4,600	4,200
Të arkëtueshmet	6,300	5,000
Paraja	<u>2,000</u>	<u>1,500</u>
	<u>12,900</u>	<u>10,700</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>33,700</b>	<b>30,490</b>
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme (€0.50 për aksion)	1,500	2,100
Fitimet e mbajtura	8,800	10,150
12% Kredi e konvertueshme	<u>3,100</u>	<u>2,450</u>
	13,400	14,700
<i>Detyrimet aftagjata</i>		
8% Aksione preferenciale të ripagueshme	3,000	1,800
12% Kredi e konvertueshme	<u>7,510</u>	<u>8,337</u>
	10,510	10,137
<i>Detyrimet aftashkurta</i>		
15% obligacion	1,600	-
Të pagueshmet tregtare	7,940	5,123
Të tjera	<u>250</u>	<u>530</u>
	9,790	5,653
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>33,700</b>	<b>30,490</b>

**Informata shtesë:**

Koeficientët e mëposhtë janë nxjerrë nga Raporti i Drejtorëve që shoqëron pasqyrat financiare:

	<b>Payton sh.a</b>	<b>Kemp sh.a</b>
Marxhina e fitimit bruto	22%	25%
Mbulimi i dividendës	4 herë	5 herë
Çmimi aktual i aksioneve (€)	2.10	1.55

**Kërkohe:**

a) Llogaritni koeficientët e mëposhtëm për të dyja entitetet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023:

- |  |            |
|--|------------|
| i) Marxhinen e fitimit operativ                | (1.5 pikë) |
| ii) Normen e kthimit mbi kapitalin e angazhuar | (1.5 pikë) |
| iii) Periudha e qarkullimit të stoqeve         | (1.5 pikë) |
| iv) Koeficienti qarkullues                     | (1.5 pikë) |
| v) Hyrjen në borxh                             | (1.5 pikë) |
| vi) Fitimin e dividendës                       | (2.5 pikë) |

b) Shkruani një raport për Drejtorin Ekzekutiv duke analizuar performancën dhe pozitën financiare të Payton sh.a krahasuar me Kemp sh.a, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Për shkrimin e raportit, përdorni vetëm koeficientët e mëposhtëm:

- |  |           |
|--|-----------|
| i) Marxhinen e fitimit operativ,               |           |
| ii) Normen e kthimit mbi kapitalin e angazhuar |           |
| iii) Hyrjen në borxh dhe                       |           |
| iv) Fitimin e dividendës                       | (10 pikë) |

(Total: 20 pikë)

5.

**a) Llogaritja e koeficientëve**

**i) Marxhina e fitimit operativ**

= FPIT / Të ardhurat x 100

FPIT nxirret nga:

	<b>Payton sh.a</b>	<b>Kemp sh.a</b>
	<b>€ 000</b>	<b>€ 000</b>
Fitimi pas tatimit	1,500	1,260
Kosto financiare	1,050	880
Provizionet për tatimin aktual	1,004	925
Zvogëlim në tatimin e shtyrë	(116)	(55)
Tatimi aktual nën provizionim 2022	-	<u>32</u>
	<b>3,438</b>	<b>3,042</b>

Marxhina e fitimit operativ =

$3,438 / 25,600 \times 100$

$3,042 / 21,900 \times 100$

**Payton sh.a**

=13.43%

**Kemp sh.a**

= 13.89%

**ii) Norma e kthimit mbi kapitalin e angazhuar**

= FPIT / kapitali i angazhuar x 100

$3,438 / (13,400 + 10,510 + 5,600) \times 100$

$3,042 / (14,700 + 10,317) \times 100$

**Payton sh.a**

=13.48%

**Kemp sh.a**

= 12.24%

**iii) Periudha e qarkullimit të stoqeve**

= Stoqet / KMSH x 365

KMSH nxjerret nga:

KMSH

Payton sh.a (25,600 x (100%-22%))

Kemp sh.a (21,900 x (100%-25%))

**Payton sh.a**

19,968

**Kemp sh.a**

16,425

Periudha e qarkullimit të stoqeve =

$4,600 / 19,968 \times 365 =$

$4,200 / 16,425 \times 365 =$

84 ditë

93 ditë

**iv) Koeficienti qarkullues**

= Pasuritë qarkulluese / Detyrimet afatshkurtëra

$12,900 / 9,790 =$

$10,700 / 5,653 =$

**Payton sh.a**

1.32:1

**Kemp sh.a**

1.89:1



**v) Hyrja në borxh**

	<b>Payton sh.a</b>	<b>Kemp sh.a</b>
=Borxhi nga interesi / (Borxhi nga interesi + ekuiteti) x 100		
(10,510+1,600) / (10,510+13,400) x 100 =	47.47%	
10,137/ (10,137+14,700) x100) =		40.81%

**vi) Fitimi i dividendës**

	<b>Payton sh.a</b>	<b>Kemp sh.a</b>
=Dividenda për aksion / Çmimi për aksion x 100		
0.125 / 2.10 x 100=	5.95%	
0.06 / 1.55 x 100		=3.87%

Dividenda për aksion u gjet duke përdorur raportin e mbulimit. Mbulimi me dividend tregon se sa herë fitimet mbulojnë dividendët ose sa herë dividendët shkojnë në fitime. Pra, nëse fitimet për aksion janë të disponueshme, ne mund të përcaktojmë lehtësisht dividendin për aksion. Fitimet për aksion llogariten si më poshtë:

Fitimet për aksion = (Fitimi pas tatimit - Div Preferenciale) / Nr. i aksioneve të zakonshme

	<b>Payton sh.a</b>	<b>Kemp sh.a</b>
1,500 / 1500/0.5 =	0.50	
1,260/2,100/0.5=		0.30
Dividenda për aksion		
0.50 / 4 =	0.125	
0.30 / 5 =		0.06

**Përmbledhje**

	<b>Payton sh.a</b>	<b>Kemp sh.a</b>
Marxhina e fitimit bruto	22%	25%
Marxhina e fitimit operativ	13.43%	13.89%
Norma e kthimit mbi kapitalin e angazhuar	13.48%	12.24%
Periudha e qarkullimit të stoqeve	84 ditë	93 ditë
Koeficienti qarkullues	1.32:1	1.89:1
Hyrja në borxh	47.47%	40.81%
Fitimi i dividendës	5.95%	3.87%
Mbulimi i dividendës	4.0	5.0

b)

## Raport për Bordin

**Për: Bordin**

**Nga: Kontabilisti**

**Data: 21 shtator 2024**

**Tema: Analizë e performances dhe pozitës financiare të Payton sh.a**

Ky raport ofron një vlerësim të performancës financiare dhe pozitës financiare të Payton sh.a, në raport me konkurrentin e saj, Kemp sh.a, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Për këtë analizë janë përdorur katër koeficientë:

1. Marxhina e fitimit operativ
2. Norma e kthimit mbi kapitalin e angazhuar (KNKA)
3. Hyrja në borxh dhe
4. Fitimi i dividendës

dhe kështu raporti duhet të lexohet duke iu referuar koeficientëve të llogaritur.

### Marxhina e fitimit operativ

Marxhina e fitimit operativ është një matës kyç i fitim - prurjes dhe ofron një tregues se sa mirë është kontrolluar kostoja e operacioneve. Ai tregon se sa fiton një entitet pasi ka mbuluar të gjitha shpenzimet operationale. Payton sh.a raporton një marzh operativ prej 13.43% që është pak më e ulët se ajo e Kemp sha prej 13.89%. Kjo do të thotë që Payton sh.a po operon me me pak efikasitet në menaxhimin e kostove të përgjithshme operationale të bëra për të fituar të ardhura.

### Norma e kthimit mbi kapitalin e angazhuar (KNKA)

KNKA është një tregues popullor i efikasitetit të menaxhimit dhe për planifikimin strategjik. Krahasimi i fitimit operativ të krijuar nga një entitet me vlerën kontabël të kapitalit afatgjatë dhe atij qarkullues tregon se sa euro fitimi janë marrë nga çdo euro i burimit nën kontrollin e menaxhmentit. KNKA tregon se sa fitimprurës duket entiteti për ofruesit e kapitalit afatgjatë. Me një KNKA prej 13.48% krahasuar me 12.24% të Kemp sh.a, Payton sh.a nuk duket më mirë për sa i përket fitimit të gjeneruar për financuesit afatgjatë. Kërkohet një vështrim kritik për të zbuluar nëse kjo pamje është si rezultat vetëm i marzheve më të ulëta që fiton Payton sh.a pasi qarkullimi i dobët i pasurive mund të luajë një rol të rëndësishëm.

### Hyrja në borxh

Hyrja në borxh është matës i rrezikut financiar dhe shpreh shumën e borxhit të një kompanie në raport me ekuitein e saj. Hyrja në borxh të Payton sh.a dhe Kemp sh.a janë përkatësisht 47.47 % dhe 40.81%. Meqenëse hyrja në borxh të të dyja kompanive është nën 50%, do të thotë që kompanitë janë të ngarkuara me pak borxh. Kjo tregon se ato përdorin më pak borxh në financimin e bizneseve. Prandaj, nuk do të ishte e vështirë për entitete të merrnin më shumë hua kur ka nevojë për të mbledhur kapital të ri. Ekziston gjithashtu rrezik i ulët që entiteti nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij të pagesës ndaj huadhënësve kur këto detyrime duhet të paguhen.

### Fitimi i dividendës

Fitimi i dividendës mat se sa të ardhura janë marrë në raport me çmimin e aksionit. Një fitim më i lartë i dividendit është më tërheqës ndërsa një fitim më i ulët mund ta bëjë një aksion më

pak konkurrues në krahasim me industrinë e tij. Fitimi i dividendës për Payton sh.a dhe Kemp sh.a është 5.95% dhe 3.87%. Kjo tregon se aksionet e Payton sh.a janë më tërheqës dhe konkurrues në krahasim me Kemp sh.a.

### **Konkluzion**

Performanca dhe pozita financiare e përgjithshme e të dyja kompanive janë shumë të ngjashme. Sipas koeficientëve të llogaritur, ka vetëm një ndryshim të vogël në performancën e kompanive. Edhe pse performanca dhe pozita financiare e të dy kompanive janë të kënaqshme, Kemp sh.a po performon pak më mirë se Payton sh.a.